



VENDIM

Nr.7, Datë 19.01.2017

MBI

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË “RREGULLAT E PËRKOHSHME TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 139 DATË, 15.08.2016 TË BORDIT TË ERE.

Në mbështetje të neneve 16; 19, gërma “a” dhe 98 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, në lidhje me disa ndryshime në “Rregullat e përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”.

Konstatoi se:

- Në nenin 98 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut dhe miratohen nga ERE pas propozimit të OST sh.a.
- ERE me vendimin nr. 151, datë 30.09.2016, pika 2 e tij, filloi procedurat për rishikimin e “Rregullave të përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.08.2016 të Bordit të ERE.
- Me shkresën nr. 705 Prot., datë 05.10.2016, ERE ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me pikat e propozuara për rishikimin e “Rregullave të përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.08.2016, pranë subjekteve: MEI, KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetit të Konkurrencës, AAES, FIAA, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël, AREA si dhe Energji Ashta sh.p.k.
- Shoqëria KESH sh.a. më shkresën e saj nr. 8286/1 Prot., datë 14.11.2016 ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me vendimin nr. 151, datë 30.09.2016 “Mbi rishikimin e Rregullave të përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”.

- ERE më datë 20.12.2016, zhvilloi një seancë dëgjimore midis përfaqësuesve të OST sh.a, dhe KESH sh.a për të diskutuar në lidhje me qëndrimin e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë disa ndryshime në “Rregullat e përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 139, datë 15.08.2016 si më poshtë :
 - Kapitulli II, në pikën II.2.2, paragrafi “viii”; - OST në funksionin e operatorit të rrjetit të transmetimit do të ketë të drejtën për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të transmetimit nga tregtarët”.- hiqet “nga tregtarët”.
 - Në kapitullin V “Kontratat dhe tarifat mes pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të parregulluar janë:”-hiqet fjala “Tarifa”, shtohet “Të parregulluar”.
 - Në Kapitullin V, paragrafin “vi” "Rregullat për kontratat dypalëshe", në pikën V.1 - vi) kontratat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.”- shtohet “dhe shërbimeve ndihmëse”.
 - Në Kapitullin III të pikës III.2, paragrafi iv, - një kopje të bilancit të fundit vjetor të certifikuar nga organet e tatimtaksave- bëhet “një kopje të certifikuar të bilancit të fundit vjetor dhe të depozituar në organet e tatimtaksave”.
 - Në Kapitullin VIII.2.2 - ERE do të miratojë çmimet e rregulluara për njësitë e gjenerimit të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik - shtohet “deri në krijimin e tregut të balancimit ose kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera të ERE”.
 - Në Kapitullin VIII.3, Paragrafi ii – nga “tarifat e mundshme të importit dhe eksportit ose energjisë gjatë dimrit në avancë” – bëhet “Çmimet e mundshme të energjisë në treg gjatë dimrit në avancë /dimrit pasardhës”.
 - Në pikën XIV.4.2, të Rregullave, zëvendësohet termi “*Furnizues Publik me Shumicë*” me “*Furnizuesi i Shërbimit Universal*”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI